REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 03.06.2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 59 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.59**
**Data: 29.05.2026**

Në bazë të dispozitave nenit 12 te Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pargrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi këtë

# VENDIM
## PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË NGASTRAVE KADASTRALE: 1793-0 Z.K.FERIZAJ PRONË PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTRËS KADASTALE 1794-0 Z.K.FERIZAJ, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.

**I**

Shpallen Interes i Përgjithshëm - Publik pjesa e ngastres kadatsrale:

- 1793-0 Z.K. Ferizaj me sipërfaqe prej 11 m² pronë e Njazi Selmanit.

**II**

Pjesa e ngastres kadastrale: 1793-0 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe prej 11m² Shpallet Interes i Përgjithshëm - Publik me qëllim të këmbimit me pjesen e ngastres kadastrale: 1794-0 Z.K. Ferizaj me siperfaqe prej 11 m² pronë e Komunës së Ferizajt. Kjo pjesë e parcelës Shpallet Interes i Përgjithshëm, për arsye se Komuna e Ferizajt vite më parë ka bërë zgjërimin e trotuarit në pronën private të tij në rrugën "Dëshmorët e Kombit".

**III**

**OBLIGOHET:** Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lart nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njësive.

**IV**

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmërive.

**V**

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës - Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

**VI**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana. 03 / 06 / 2026
Nr.Orgv Org.Jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 60 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

01.Nr.60
Data: 29.05.2026

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, nenit 24. Parag.4 i Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pargrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi këtë:

# Vendim

**Për Shpalljen Interes i Përgjithshëm-Publik të ngastrave kadatsrale:57-5, 57-3, 152-1, 62-1, 63-6, 63-4 Z.K.Sazli, Pronë Private, me Qëllim të Këmbimit me Pjesën e Ngastrës Kadastrale 350-0 Z.K.Sazli Pronë e Komunës së Ferizajt.**

**I**

Shpallen interes i përgjithshëm publik pjesët e ngastrave kadastrale: 57-5 Z.K. Sazli, me sipërfaqe prej 25 m², 57-3 Z.K. Sazlie, me sipërfaqe prej 25 m², 152-1 Z.K. Sazli, me sipërfaqe prej 59 m², 62-1 Z.K. Sazli, me sipërfaqe prej 81 m², 63-6 Z.K. Sazli, me sipërfaqe prej 58 m², 63-4 Zk. Sazli me sipërfaqe prej 54 m², prona private të Fahrije (Qerim) Svarqa.

**II**

Ngastrat kadastrale: të përshkruar në pikën 1 të vendimit Shpallen Interes i Përgjithshëm-Publik me qëllim të këmbimit me pjesen e ngastres kadastrale 350-0 Z.K. Sazli pronë e Komunës së Ferizajt.

III

Këto parcela Shpallen e Interes i Përgjithshëm për arsye se me parë, është realizuar projekti i rrugës.

**IV**

Shfuqizohen vendimet e 01.Nr.24 te dates 25.03.2021 dhe Vendimi 01.Nr.68 i dates 31.03.2023, për shkak te projektit te autostrades, ku në parcelat te cilat shtrihen në ZK. Sazli është bërë ndryshimin ne ndarjen e parcelave.

V

Obligohet Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lart nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Kembim të këtyre njësive.

VI

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmëive.

VII

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VIII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 03.06.2026
Nr.Orgv / Org.jed 01 | Nr.Prot. / Br.Prot. 61 | Nr.Faqeve. / Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.61**
**Data: 29.05.2026**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit Nr.03/L- 040 për Vetqeverisjen Lokale, nenit 5, paragrafi 5,2, nenit 8, paragrafi 8.2, të Ligjit Nr. 03/L-87, për Ndërmarrje Publike, si dhe neni 10 paragrafi 2.4 dhe neni 25, paragrafi 2.5, të Statutit të Komunës Ferizaj 01.Nr.50, të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 mori këtë:

# VENDIM
# PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË NDËRMARRJEN PUBLIKE N.P.L "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.FERIZAJ.

**I**

Me këtë Vendim Kuvendi i Komunës së Ferizajt emëron dy anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen publike N.P.L "Stacioni i Autobusëve" SH.A.Ferizaj, dhe atë:

1. **Abedin Ramadani**
2. **Edona Sylejmani**

**II**

Komisioni i përmendur në pikën 1 të këtij vendimi i përgjigjet Kuvendit të Komunës së Ferizajt mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni po ashtu do t'i raportoi Kuvendit të Komunës në baza vjetore si dhe t'i siguroi të dhëna kualitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit të Komunës mbi natyrën e menaxhimit të ndërmarrjes publike N.P.L "Stacioni i Autobusëve" SH.A.Ferizaj në interes të Komunës.

**III**

Komisioni për punën e kryer do të kompenzohet me një vendim të vaçantë.

**IV**

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi pushojnë së vlejturi të gjitha Vendimet e mëhershme për caktimin e anëtarëve në Komisionin Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjeve publike N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A.Ferizaj nga kompetenca e Kuvendit.

**V**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës - Ferizaj.

**VI**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana. 03.06.2026
Nr.Orgj. Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 62 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.62**
**Data: 29.05.2026**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale, nenit 5, paragrafi 5,2, nenit 8, paragrafi 8.2, të Ligjit Nr. 03/L-87, për Ndërmarrje Publike, si dhe neni 10 paragrafi 2.4 dhe neni 25, paragrafi 2.5, të Statutit të Komunës Ferizaj 01.Nr.50, të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 mori këtë:

## VENDIM
## PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË NDËRMARRJEN PUBLIKE N.P.L. "AMBIENTI" SH.A. FERIZAJ.

**I**

Me këtë Vendim Kuvendi i Komunës së Ferizajt emëron dy anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen publike N.P.L. "Ambienti" SH.A.Ferizaj, dhe atë:

1. **Fatmir Ademi**
2. **Avni Nuha**

**II**

Komisioni I përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi i përgjigjet Kuvendit të Komunës së Ferizajt mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni po ashtu do t'I raportoi Kuvendit të Komunës në baza vjetore si dhe t'i siguroi të dhëna kualtitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit të Komunës mbi natyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes Publike N.P.L. "Ambienti" SH.A.Ferizaj në interes të Komunës.

**III**

Komisioni për punën e kryer do të kompenzohet me një vendim të vaçantë.

**IV**

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi pushojnë së vlejturi të gjitha Vendimet e mëhershme për caktimin e anëtarëve në Komisionin Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjeve publike N.P.L. "Ambienti" SH.A.Ferizaj nga kompetenca e Kuvendit.

V

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës - Ferizaj

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 03 / 06 / 2026
Nr. Org / Org. jed. 01 | Nr. Prot. / Br. Prot. 63 | Nr. Faqeve / Br. Strana 2
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.63**
**Data: 29.05.2026**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale, nenit 5, paragrafi 5,2, nenit 8, paragrafi 8.2, të Ligjit Nr. 03/L-87, për Ndërmarrje Publike, si dhe neni 10 paragrafi 2.4 dhe neni25, paragrafi 2.5, të Statutit të Komunës Ferizaj 01.Nr.50, të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 mori këtë:

# VENDIM
# PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË NDËRMARRJEN PUBLIKE KRM "PASTËRTIA" SH.A.FERIZAJ.

**I**

Me këtë Vendim Kuvendi i Komunës së Ferizajt emëron dy anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve në ndërmarrjen publike K.R.M. "Pastërtia" SH.A.Ferizaj, dhe atë:

1. **Leotrim Ilazi**
2. **Fatmir Xhakli**

**II**

Komisioni i përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi i përgjigjet Kuvendit të Komunës së Ferizajt mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni po ashtu do t'i raportoi Kuvendit të Komunës në baza vjetore si dhe t'i siguroi të dhëna kualtitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit të Komunës mbi natyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes publike KRM "Pastërtia" SH.A.Ferizaj në interest ë Komunës.

**III**

Komisioni për punën e kryer do të kompenzohet me një vendim të vaçantë.

**IV**

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi pushojnë së vlejturi të gjitha Vendimet e mëhershme për caktimin e anëtarëve në Komisionin Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjeve publike K.R.M "Pastërtia" SH.A.Ferizaj nga kompetenca e Kuvendit.

**V**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

**VI**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 03,06,2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 64 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.64**
**Data: 29.05.2026**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale si dhe nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi këtë:

**VENDIM**
**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË DËMEVE MATERIALE NGA FATKEQSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA, TË SHKAKTUARA NGA TEMPERATURAT E ULËTA DHE NGRICAT NË FIDANISHTE TË PEMËVE.**

**I**

**MIRATOHET**: Raporti i Komisionit të vlerësimit të dëmeve materiale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, të shkaktuara nga temperaturat e ulëta dhe ngricave në fidanishte të pemëve.

**II**

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është i bashkangjitur edhe Raporti i detajuar i komisionit të dëmeve nga fatëkeqësit natyrore.

**III**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Emergjente në Komunën e Ferizajt si dhe Kuvendi i Komunës.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana. 03/06/2026
Nr.Orgv / Org.jed 01 | Nr.Prot. / Br.Prot. 65 | Nr.Faqeve. / Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.65**
**Data: 29.05.2026**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale si dhe nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi këtë:

# VENDIM
## PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË DËMEVE MATERIALE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA.

**I**

**MIRATOHET**: Raporti i Komisionit të vlerësimit të dëmeve materiale nga fatkeqsitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

**II**

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është i bashkangjitur edhe Raporti i detajuar i komisionit të dëmeve nga fatëkeqësit natyrore.

**III**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Emergjente në Komunën e Ferizajt si dhe Kuvendi i Komunës.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 03.06.2026
Nr.Orgv / Org.jed 01 | Nr.Prot. / Br.Prot. 66 | Nr.Faqeve. / Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.66**
**Data: 29.05.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17 shkronja b, neni 40 shkronja i, neni 58 pika 1.h të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt me Nr.01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR PLOTËSIMIN E LISTËS REZERVË PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE, NË KOMUNËN E FERIZAJT.

### I

Plotësohet Lista rezervë për Emërtimin e rrugëve në Komunën e Ferizajt me këta emra:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Rafiz Sejdiu | Veteran i UÇK |
| 2. | Bekim Mehmetizharava | Veteran i UÇK |
| 3 | Imer Grainca | Veprimtar |
| 4 | Azem Llabjani | Veprimtar |
| 5 | Albin Kurtaliqi | Propozim i Ri |
| 6 | Ramadan Hajdari | Veteran i UÇK |
| 7 | Bajram Tahiri | Artist |
| 8 | Milaim Avdiu | Doktor |
| 9 | Parisi | Propozim i Ri |
| 10 | Rrahman Murseli | Veteran i UÇK |
| 11 | Ramadan Nuha | Veteran i UÇK |
| 12 | Naim Ymeri | Veteran i UÇK |
| 13 | Bajram Çerkini | Profesor |
| 14 | Ramadan Sahiti | Propozim familjar |
| 15 | Fehmi Grajqevci | Veteran i UÇK |
| 16 | Esat Kurtaliqi | Veteran i UÇK |

| | | |
|---|---|---|
| 17 | Bekim Bërkolli | zyrtar i MPB |
| 18 | Blerim Asllani | Afarist |
| 19 | Gafurr Behluli | Veteran i UÇK |
| 20 | Ismajl Reçica | Propozim familjar |
| 21 | Jusuf Kamenica | Propozim familjar |
| 22 | Rasim Kamenica | Propozim familjar |

**II**

Për realizimin e këtij Vendimi përkujdeset Drejtoria e Urbanizmit, Kuvendi i Komunës dhe Kryetari Ferizaj.

**III**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 03/06/2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 67 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 7
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.67**
**Data: 29.05.2026**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040, neni 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt me Nr. 01. Nr.50 i datës 28.06.2013 si dhe Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr.03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194 dhe me Ligji Nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2026, Neni 8 pika 7. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë Vitit 2025 dhe të regjistruara në SIMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për Vitin 2025, barten në Vitin 2026 në përputhje me Vendimin e Kuvendit të Komunës.

Të hyrat vetanake të Vitit 2025 të cilat do të barten në Vitin 2026 janë në shumën prej **2,514,228.80€**. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave, ligjit të buxhetit për Vitin 2026 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet e organizatës buxhetore. Nisur nga kjo, propozimi ynë për shpërndarjen e tyre në kategoritë ekonomike të shpenzimeve dhe në programet buxhetore si më poshtë. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi këtë:

## VENDIM

## PËR BARTJEN E MJETEVE THV NGA VITI 2025 NË VITIN 2026

**I**

**MIRATOHET:** Propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr.01.Nr.121/26 i datës 20.05.2026 për bartjen e mjeteve THV nga Viti 2025 në Vitin 2026.

**II**

Gjithësej bartet nga Viti 2025 në Vitin 2026 shuma prej **2,514,228.80€**.

**III**

Shpërndarja e mjeteve të bartura do të realizohet si më poshtë

**Kategoritë ekonomike:**

Mallra dhe shërbime 864,228.80€
Investimet kapitale 1,250,000.00€
Shpenzimet komunale 400,000.00€

**Në kategorinë e shpenzimeve mallra dhë shërbime:**

Infrastruktura Rrugore (18032) shuma prej 264,228.80€
Kujdesi primar shëndetësor (74900) shuma prej 250,000.00€
Administrata e arsimit (92160) shuma prej 250,000.00€
Sherbimet kulturore (85032) shuma prej 100,000.00€

**Në kategorinë e shpenzimeve komunale:**

Administrata (16332) shuma prej 400,000.00€

**Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:**

Sipas listës së projekteve si në vijim:

| Nr. | Programi | Kodi i Programit | Kodi i projektit | Emri i Projektit | Vlera për bartje | Arsyetimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Infrastruktura Publike | 18192 | 51651 | Ndërtimi i nënkalimit për vetura dhe këmbësor afër Stacionit policor në Ferizaj | 250,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 2 | Infrastruktura Publike | 18192 | 90493 | Asfaltimi i rrugës kryesore në Fshatin Cërnillë | 30,000.00 | Nenshkrimi i konttrates qe pret qe 6 muaj per nenshkrim |
| 3 | Infrastruktura Publike | 18192 | 90509 | Ndërtim i kolektorit Nikadin - Gërlicë, faza e I-rë | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 4 | Infrastruktura Publike | 18192 | 48311 | Asfaltimi i rrugicave në Bablak dhe rrugicave të mbetura në Fshatin | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Tern dhe Prelez i Jerlive | | |
| 5 | Infrastruktura Publike | 18192 | 48319 | Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore të fshatit dhe rrugëve të mbetura në Fshatin Komogllavë | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 6 | Infrastruktura Publike | 18192 | 49948 | Asfaltimi i rrugëve në Fshatin Balaj | 30,000.00 | Nenshkrimi i konttrates qe pret qe 6 muaj per nenshkrim |
| 7 | Infrastruktura Publike | 18192 | 51366 | Hapja e puseve të ujit të pijshëm në Kosinë dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit Kosinë, Dremjak | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 8 | Infrastruktura Publike | 18192 | 51565 | Rikonstruimi i rrugës kryesore në Fshatin Gaçkë | 30,000.00 | Nenshkrimi i kontrates qe pret qe 6 muaj per nenshkrim. |
| 9 | Infrastruktura Publike | 18192 | 51572 | Asfaltimi i rrugëve në Softaj - Lagjia Raqe dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen Kamenica | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 10 | Infrastruktura Publike | 18192 | 51650 | Rregullimi i rrjetit të ujit të pijshëm në Fshatin Rakaj | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 11 | Infrastruktura Publike | 18192 | 53047 | Asfaltimi i rrugës Gaçkë Topojan Gërlicë dhe rregullimi i ujësjellësit në Lagjen Bajram Curri | 50,000.00 | Nenshkrimi i konttrates qe pret qe 6 muaj per nenshkrim dhe aneks kontrata për fazen e I |
| 12 | Infrastruktura Publike | 18192 | 53048 | Asfaltimi i rrugëve të mbetura në Fshatin Pleshinë | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 13 | Infrastruktura Publike | 18192 | 53050 | Rikonstruimi i rrugës kryesore në Prelez të Jerlive | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | skadon kontrata |
| 14 | Infrastruktura Publike | 18192 | 53567 | Pjesëmarrja më projekte me donator për investime në Qytetin e Ferizajt | 50,000.00 | Anekse ne disa kontrata me bashkëfinancim |
| 15 | Infrastruktura Publike | 18192 | 53723 | Rikonstruimi i rrjetit të ndriçimit publik në zonat I, II, III, dhe IV dhe në Fshatrat Greme, Komogllavë, Rahovicë, Dardani, Sojevë, Kosinë | 30,000.00 | Inicimi i kontratës së re, shumë e neviojshme |
| 16 | Infrastruktura Publike | 18192 | 54705 | Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Fshatrat Neredime, Dremjak, Mirosalë dhe Gaçkë | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 17 | Infrastruktura Publike | 18192 | 44054 | Asfaltimi i rrugës kryesore në Fshatin Dremjak | 30,000.00 | Nenshkrimi i konttrates qe pret qe 6 muaj per nenshkrim |
| 18 | Infrastruktura Publike | 18192 | 44063 | Asfaltimi me aktër korsi i rrugës "Cen Dugolli" dhe Reçakut nga Policia deri te lidhja me Rr. "Cen Dugolli" | 30,000.00 | Nenshkrimi i konttrates qe pret qe 6 muaj per nenshkrim |
| 19 | Infrastruktura Publike | 18192 | 51336 | Asflatimi i rrugëve dhe rregullimi i trotuarëve në Fshatrat Varosh, Fshat i Vjetër, Bibaj dhe Nikadin | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 20 | Infrastruktura Publike | 18192 | 44100 | Pjesëmarrja në projekte me donatorë, ujësjellesi në Fshatin Sojevë, Dardani dhe Zllatar | 50,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 21 | Infrastruktura Publike | 18192 | 49955 | Asfaltimi i rrugës Zaskok Ferizaj | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | skadon kontrata |
| 22 | Infrastruktura Publike | 18192 | 21073 | Rregullimi i kanalizimit fekal në Prelez dhe Muhoc | 30,000.00 | Inicimi i kontratës së re, shumë e neviojshme |
| 23 | Infrastruktura Publike | 18192 | 21054 | Asfaltimi i rrugëve në Lagjen e Sherretëve dhe Riza Matoshi | 30,000.00 | Inicimi i kontratës së re, shumë e neviojshme |
| 24 | Infrastruktura Publike | 18192 | 50986 | Rregullimi i kanalizimit në Fshatin Zaskok dhe asfaltimi i rrugëve në Doganaj | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 25 | Infrastruktura Publike | 18192 | 53061 | Shqyrtimet gjeomekanike për të gjitha projektet e investimeve kapitale për qytetin e Ferizajt | 30,000.00 | Pagesë që pret mbi një vit |
| 26 | Turizmi | 48072 | 53097 | Ndërtimi i infrastrukturës së zonave turistike në Jezerc | 40,000.00 | Nenshkrimi i aneksit per dy kontrata pasi i skadon kontrata |
| 27 | Planifikimi Urban dhe Inspeksioni | 66465 | 51527 | Ndërtimi i parkut të ri në lokacionin ekzistues të Ndërmarrjes "Pastërtia" | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 28 | Shërbimet e shëndetësisë primare | 74900 | 51535 | Ndërtimi i QMF në Koshare | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 29 | Sporti dhe rekreacioni | 85112 | 54782 | Ndërtimi i tribunave në Stadiumin "Tefik Çanga" në Fshatin Tërrn | 30,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |
| 30 | Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93930 | 49853 | Ndërtimi i Shkollës së re në Neredime | 60,000.00 | Nenshkrimi i aneksit pasi i skadon kontrata |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 | Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjenca | 18032 | 53517 | Rregullimi i rrugëve dhe trotuarëve me asfalt dhe kubëza; Rr. "Dëshmorët e Kombit",12 Qershori, "Enver Topalli", Epopeja e Jezercit, A. Bytyqi, F.Ratkoceri | 30,000.00 | Inicimi i kontratës së re, shumë e neviojshme |
| | | | | **Gjithësej:** | **1,250,000.00** | |

Infrastruktura Publike (18192) 1,030,000.00€
Turizmi (48072) 40,000.00€
Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66465) 30,000.00€
Shërbimet e shëndetësisë primare (74900) 30,000.00€
Sporti dhe rekreacioni (85112) 30,000.00€
Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93930) 60,000.00€
Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjenca (18032) 30,000.00€

**IV**

- **Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve**, kërkohet bartja e mjeteve në shumën prej **864,228.80 €**, me qëllim mbulimin e obligimeve të kontraktuara nga vitet paraprake, si dhe për financimin e aktiviteteve të domosdoshme si: funksionalizimi i qerdheve publike, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve administrative, shëndetësore dhe arsimore, sigurimi fizik i objekteve, e të ngjashme.
- **Në kategorinë e shpenzimeve komunale**, kërkohet bartja e shumës prej **400,000.00 €**, për të mbuluar shpenzimet e energjisë elektrike, ujit, telefonisë dhe shërbimeve të tjera të ngjashme që janë esenciale për funksionimin normal të komunës.
- **Në kategorinë e shpenzimeve kapitale**, kërkohet bartja e shumës prej **1,250,000.00 €**, për mbulimin e obligimeve të kontraktuara gjatë vitit 2025 dhe viteve paraprake, për vazhdimin e projekteve të papërfunduara, si dhe lidhjen e kontratave, mjetet e të cilave janë ekzekutuar për vendime gjyqësore dhe përmbarimore.

**V**

**Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria e Financave Ferizaj**

**VI**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana. 03/06/2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 68 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.68**
**Data: 29.05.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR RISHQYRTIMIN DHE PLOTËSIM - NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR: 41 I DATËS 30.04.2025 I PEZULLUAR SIPAS VENDIMIT ME NR: 89 I DATËS 30.09.2025

### I

Rishqyrtohet vendimi Nr: 41 i datës 30.04.2025 i pezulluar sipas vendimit me Nr. 01.Nr.89 datë 30.09.2025, ashtu që ndryshohet preambula e Vendimit me Nr. 41 datë 30.04.2025, dhe bëhet: Në bazë të dispozitave të nenit 58 pika 1.h të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Stautit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (qrk) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

### II

Pikat tjera të Vendimit me Nr.41 të datës 30.04.2025 të cilat nuk preken nga ky Vendim mbesin në fuqi.

### III

Për realizimin e këtij Vendimi përkujdeset Drejtora për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër Ferizaj.

### IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**